



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr.350/02-0070274/25 dt.21.05.2025, (E-Leja me nr. KKN-00299), në emër të aplikuesit QKUK, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e ndërtesës “Onkologjia” në kuadër të QKUK me etazhitet -1B, në kuadër të Planit Rregullues Prishtina e Re Zona Perëndim -Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.2805-9 Z.K.Prishtinë, e cila ndodhën në bllokun urban “A-3”, me destinim “Publik-institucion Shëndetësor”, në kuadër të Planit Rregullues Prishtina e Re Zona Perëndim në Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 27.05.2025 deri më 10.06.2025, në e-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesë individuale, shtëpi banimi, me etazhitet -1B.
b. Vija rregulluese	sipas Planit Rregullues Prishtina e Re Zona Perëndim
c. Vija ndërtimore	sipas Planit Rregullues Prishtina e Re Zona Perëndim
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	në vijën ndërtimore
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	3.00m`/3.00m`, nga ana e djathtë. 3.00 m`/3.00 m`, ana e majtë
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP ~560.55 m ² , e propozuar.
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ 40 %, e lejuar
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=S=560.55m ² , e propozuar.
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=560.55 e propozuar.
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	1 Vendparkingje te jashtë
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	/
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
m. A ka qasje te pakufizuar ne rruge publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
n. shfrytëzimi i propozuar a do te gjenerojë ndotje te mjedisit apo zhurmë me te madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore ne Zona te Mbrojtura, Zona te veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.06/2017,dt.23.05.2017,për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari:

